



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

U D H Ë Z I M

Mbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit nga Zyrtarët e Prokurimit

Nr. 3, datë 24.10.2016

Agjencia e Prokurimit Publik, në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neneve 56 dhe 64 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Udhëzon:

1. Konflikt interesi është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa personale, të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe të përgjegjësive të veta publike.

Pikërisht për të shmangur këtë situatë, nga ana e Titullarit i të autoritetit kontraktor ose Zyrtarit të autorizuar prej tij, si personat përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës dhe komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit, duhet të sigurohet një ndarje e qartë e detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumentave të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Për këtë qëllim, Titullari i autoritetit kontraktor ose Zyrtari i autorizuar në emërimin e një nëpunësi prokurimi duhet të mbajë parasysh kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, kërkesa këto që parashikon neni 21 i Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Përpara se të emërohen si zyrtarë të prokurimit në cilësinë: *anëtar në njësinë e prokurimit, anëtar në grupin e punës për përlogaritjen e fondit limit/hartimin e specifikimeve teknike, anëtar në komisionin e vlerësimit të ofertave dhe anëtar në komisionin e prokurimit me vlerë të vogël*, këta zyrtarë duhet të nënshkruajnë një deklaratë, përmes së cilës ato duhet të vetëdeklarojnë nëse ndodhen ose jo në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar.

Në rast se, zyrtari/zyrtarët në fjalë deklararon se, ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, atëherë ky i fundit duhet t'ja bëjë me dije gjendjen e tij Titullarit të autoritetit kontraktor ose Zyrtarit të autorizuar prej tij, me qëllim që ky i fundit t'a marrë në konsideratë këtë fakt gjatë procesit të emërimit të tij.

Deklarata që nënshkruhet në këtë rast nga zyrtarët e mësipërm të prokurimit është Formulari i Deklarimit, sipas Shtojcës Nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Për të shmangur trajtimin e pabarabartë për arsye të ekzistencës së konfliktit të interesave, në procedurat e prokurimit publik, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave nuk mund të marrin pjesë në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në rastin kur ato janë në konflikt interesi me ofertuesit pjesëmarrës.

Për këtë qëllim, në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave, pra anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, janë të detyruar që të bëjnë një vetëdeklarim nëpërmjet nënshkrimit të një deklaratë, ku ata duhet të deklarojnë se, nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës, sipas parashikimeve të nenit 21/3 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar, nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 709 të Kodit Civil.

Pra, ndërmjet anëtarit/anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave nuk duhet të ekzistojnë interesa private (pasurore dhe jo pasurore) me ofertuesin/ofertuesit, të cilat mund të përbëjnë shkak për lindjen e një konflikti interesi. Pikërisht për të shmangur këtë situatë, anëtari/anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të vetëdeklarojnë gjendjen e tyre në momentin e hapjes së ofertave.

Nëse evidentohet se, një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej operatorëve ekonomikë, dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti, pra përpara momentit të hapjes së ofertave, atëherë zyrtari/zyrtarët në fjalë duhet t'ja bëjë me dije gjendjen e tij Titullarit të autoritetit kontraktor ose Zyrtarit të autorizuar prej tij, me qëllim që ky i fundit të marrë masat për zëvendësimin e tij dhe, më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.

Deklarata që nënshkruhet në këtë rast nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave është Formulari i Deklarimit, sipas Shtojcës Nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim shoqërohet me formularët standarde të deklarimit, Shtojcat Nr.1 dhe Nr. 2, të cilat plotësohen nga nëpunësit e prokurimit.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti

Shtojca Nr. 1

FORMULAR DEKLARIMI

Deklaruesi: Z/Znj _____

Pozicioni: _____

Vendi i Punës _____

Në mbështetje të nenit 56 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Unë nënshkruesi _____

(emër,atësia, mbiemër)

Kandidat për anëtar në:

- njësinë e prokurimit;
- grupin e punës për përlogaritjen e fondit limit;
- grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike;
- komisionin e vleresimit të ofertave;
- komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.

Sot me datë ___/___/_____ nën përgjegjësinë time të plote, deklaroj se, _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon neni 21 i Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë ___/___/_____

Nënshkruesi _____

Shtojca Nr. 2

FORMULAR DEKLARIMI

Deklaruesi: Z/Znj _____

Pozicioni: _____

Vendi i Punës: Drejtoria/Sektori _____

Në mbështetje të nenit 64, pika 2 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Unë nënshkruesi _____,

(emër, atësia, mbiemër)

Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i caktuar me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor ose personit të autorizuar prej tij, në procedurën e prokurimit me objekt “_____”, të shpallur nga _____ në rolin e autoritetit kontraktor, sot më datë ___/___/_____ nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se, _____ në kushtet e konfliktit të interesit, me _____ ofertuesin/ofertuesit pjesëmarrës, sipas parashikimeve të nenit 21/3 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar, nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 709 të Kodit Civil.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë ___/___/_____

Nënshkruesi _____